Vdekje fashizmit — Liri Popullit

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

DY HERE NE JAVE:
T'ENJTEN DHE TE DIELLEN

Redaksija Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 192 din
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Drejtori pergjegjes SEDAT DIDA

Vjeti IV Nr. 169 | PRISHTINE, e dielle 19 Dhetuer 1948 | Çmimi 2 dinarë

Njizetedy Dhetori - dita e Armates Jugosllave

Popuji e Jugosllavis e festojne 22 Dhetorin si kujtim te perhershem ne diten kur shoku Tito formoi brigaden e pare Nacjonal-çlirimtare sulmuese. Kjo ka qene njisija e I-re e rregullt e Armates. Rruga e saje luftarake ka fillue prej qytetit Rudo me 22 Dhetuer 1941, dhe ka mbarue ne Triesle me 9 Maj 1945. Gjatesija e kesaj rruge perbahet prej 18 mije Km, ne te cilen kjo brigade ka vra, ka zane rob dhe ka lane te plagosun afer 45 mije oficera dhe ushtare t'anmikut, tue zane dhe shkatrue teknikon e madhe luftarake t'anmikut. Kontributi i brigades se pare proletare per zhvillimin e Armates s'one asht shum i madh, ajo ka qene vendi prej kah kane linde kuadrat pa pra per njisinat qe formoheshin ma pastaj. Ajo ka qene mbajtsja praktike e vllaznimit dhe bashkimit te popujve t'one, mbassi ne te kane luftue e nepermjet te saje kane kalue luftaret e te gjitha krahinave te Jugosllavis dhe i ka pershkue te gjitha republikat t'ona me perjashtim t'asaje te Maqedonis, tue ia spjegue popullit linjen e Partis Komuniste dhe tue i thirre ne lufte t'armatosuna, si e vetmja rrug, per çlirimin definitiv.

Ne periudhen e formimit te brigades se I—re proletare, fuqit t'ona numrojshin afer 91 mije luftare te perfshime ne brigaden e pare „Proletare", 66 arradhe partizone, 24 batalione me vehte, 24 kompani si dhe 7 togje me vehte. Ne ket kohe okupatori ka mbajte 25 divizjone me afer 510 mije ushtar. Ne vjetin 1942, ky, fuqit e veta i rriti ne 36 divizjone, me afer 60 mije ushtare anmiq dhe ne vjetin 1943 ne Jugosllavi luftojne 39 divizjone t'anmikut me afer 70 mije ushtare.

Per me mujt me udheheqe ma leht, me operacionet ushtarake, komanda Gjermane per sinjdhesen Ballkanike asht transferue prej Selanikut per ne Beograd dhe kjo ka udheheqe me te gjitha fuqit e okupatorit dhe tradhetarve te vendit te Ballkanit. Kjo pasqyr e shifrave te fuqinave t'anmikut qe kane qene ne Jugosllavi, ne menyre bindse tregojne se kundra çfare fuqive ka luftue ushtrija e Jone Nac—çlirimtare dhe cilat fuqi jane lidhe me teritorin t'one tue iu lehtesue aleatve te frontit te perendimit dhe t'Afrikes.

Armata e jone ka linde prej luftes partizane si forme e luftes se pergjithshme popullore kundra okupatorit dhe elementave antipopullor, te cilen kane dashte me perfitue prezences e anmikut per me lufte kundra ushtris Nacjonal—çlirimtare. Tue luftue ne ket menyre, Armata e Jone qysh prej ditve te para perfaqsonte nji fuqi serioze n'anen e aleatve dhe ka dhane kontribut te madh ne triumfin mbi Gjermanin Hitlerjane. Tue mos pase teritore te perhershme te lira, qeverija revolucjonare, industrin luftarake dhe mjetet materjale per furnizim Armata e jone ne procesin e zhvillimit te saje ka kalue neper rrugen te veshtira. Anmiku mire i ka njoft te fuqit t'ona dhe karakterin e luftes t'one dhe prandaj e ka llogarite qe me anen e ofansivave te tmerrshme dhe masovike te shkatrroje ushtrin Nacjonal—çlirimtare. Jane prue fuqi te perja, jane koncentrue disa mija ushtare kane kalue te shtat ofansivat, por ushtrija e jone Nac-Çlirimtare prej te gjithe ofansivave kane dale triumfuse tue fitue fuqi te dhetefishta nga ardhja e luftarve te rij. Fitime te tejilla ka mujte me i korre ushtrija Nacjonal-çlirimtare vetem nen udheheqjen e Partis Komuniste, ne krye me komandantin suprem, prisin dhe strategun t'one, shokun Tito, pse linja e saje ka qene e kjarte, ku popujt t'one shifshin fitoren e sigurt dhe Jugosllavin socjaliste te sodit,

Mareshali Tito — udheheqsi gjenjal i Armates Jugosllave

pse kjo ka qene ushtrija e vullnetarve, luftarve koshient, te dhanun per popullin dhe vendin e tyne. Ne radhet e para te kesaj ushtrije gjindeshin komunistat dhe te rijt komunista, te cilet kane tregue heroizma te shumta dhe te pashoqe. Te gjitha keto e kane ba te mundeshme qe Armata e Jone me prite perqafimin vllaznuer me Armaten Sovjetike, me korpuse e divizjone, te cilat fuqi numrojshin ma se 500 mije ushtare t'armatosun mire dhe me nji eksperience te madhe luftarake.

Ndihma materjale per Armaten t'one nga jashte ka ardhe ne kohen kur popujt t'one kane shenue fitore te mdha mbinjerzore ne historin e tyne. Kah mbarimi i vitit 1942, shtabi suprem ka formue divizjone dhe korpuse, asht formue AVNOJ-i, asht çlirue nji pjese e teritoris ne te cilen asht organizue dhe stabilizue pushteti popullor. Nepermjet pese ofensivave t'anmikut. Armata e jone asht kalite, derisa udheheqesat e saje kane mbrijte me u-pajise me eksperiencen e pasun luftarake, n'ofansiven e katert kane mbrrijte ne disfate te madhe çetniket e Drazho Mihajloviqit; n'ofansiven e katert dhe te peste luftaret t'one u kane qindrue perpjekjeve mbinjerzore dhe me ket kane vertetue kualitetin e nalte te njisinave t'ona. Mbas ketyne ofansivave okupatori nuk asht perpjeke ma me i rrethue fuqit t'ona, mbassi qe te pese ofensivat e deritashme nuk kane pase sukses. Tue falenderue udheheqsin'e zgjuet te Partis s'one ne krye me shokunTito, njoftjen e teoris Marksiste - Leniniste dhe adaptimin praktik te saje ne kenditat t'ona, na deri atehere kemi krye edhe nji pjese te madhe te revolucjonit, prej kesaj shifet sa asht kontributi i popujve t'one ne luften e dyte - luften fitoese, zgjanimin dhe forcimin e fuqive demokratike ne mbare boten, ne krye me Bashkimin Sovjetik.

Kontributet e mdha t'ushtris Nacjonal-çlirimtare ne gjysmen e dyte te vjetit 1944, çlirimi i pjeses se ma dhe t'atdheut t'one e veçanerisht Serbin dhe Beogradin dhe, me ardhjen e luftareve te rij ne radhet t'ona, i kane dhane mundesi komandantit t'one Suprem qe ushtrin Nacjonal - çlirimtare me nji mars 1945 t'a riorganizoje n'Armaten moderne te Jugosllavis.

Karakteri i Armates s'one asht formulue me programin e PKJ, i cili asht pranue ne Kongresin e Peste te Partis s'one, ku thuhet: „Armata Jugosllave asht armata e popullit kjo tue fillue nga luftare deri ne komandant lufton per ruejtjen e fitimeve te luftes Nacjonal-çlirimtare, per ruejtjen dhe forcimin e pushtetit popullor, per interesin e masave popullore dhe per sigurimin e ndertimit te socjalizmit.

Armata Jugosllave mpron liria dhe pamvarsin e popujve te Jugosllavis.

Persa i perket detyrave t'ardheshme ne lidhje me Armaten t'one, Partija i ka paraqite Kongresit te Peste detyret si ma poshte:

1. Forcimin e gjithanshem t'Armates Jugosllave vazhdimisht, forcimin e shkathtesis se saje luftarake.

2. Ngritjen e jetes kulturale politike te perbamjes ushtarake e komanduese;

3. Ngritjen dhe specjalizimin e kuadrit komandues;

4. Forcimin e disiplines;

5. Furnizimin e Armates me teknikeu moderne te luftes;

6. Me zhvillue patriotizmin socjalist dhe frymen Internacjonale n'Armaten Jugosllave dhe dashtenin e masave popullore ndaj Armates, forcimin e gjithanshem ne mes te popujve dhe t'Armates.

Detyret e paraqituna kane me i krye popujt e Jugosllavis, nepermjet perpjekjeve t'udheheqesave dhe t'ushtarve t'Armates s'one, nepermjet te kryemjes se Planit pesvjeçar te Titos, ku marrin pjese aulmuesit t'one, novatoret dhe pjesa tjeter e popujve punonjes te qytetit dhe te katundit, te cilet me punen e tyne e forcojne fuqin ekonomike t'atdheut t'one. Organizatat e rinis popullore do t'apin kontributin e madh ne ngritjen politike dhe kulturale te rinis perpara se me ardhe n'Armate.

Ne periudhen e mbasluftes Armata Jugosllave asht mprojtesa e sigurte e kufijve t'one, shkolla edukative e rinis s'one dhe garantimi i ndertimit te socjalizmit. Keto detyra ajo mundet me i krye per arsye se njerzit e tij jane t'edukuem ne shkencen marksiste-leniniste, pse asht e lidhun ngushte me popullin e vet dhe ne te ka reserva te pashterrshme, pse krijuesi i tij asht Partija Komuniste, ne krye me Komandantin Suprem shokun TITO.

Brigada e Frontit populluer e Gilanit shpalle gara ne ndere te Kongresit te II-te te PK te Serbis

Me 14 te ketij mueji, ne konferencen e brigades se V-te te Frontit populluer te Gilanit, ku mueren pjese te gjithe antaret e brigades, ata kerkuen njizanit qe t'u shpallin gara te gjitha brigadave te Frontit populluer, te cilat punojne ne teritorin e Krahines s'one ase edhe n'ate te Serbis.

Tue i ftue te gjitha organizatat e Frontit populluer ne gara per ndere te Kongresit te II-te te PK te Serbis, brigada e V-te e Frontit populluer te Gilanit i ka shpalle garat ne keto pika.

1) Kush mundet me e tejkalue planin me 50 per qind;

2) Cila brigade ka me dhane ma teper ore pune vullnetare;

3) Cila brigade ka me e mbajte pastertin ma mire te zyres se shtabit, dhomave te fjetjes, kuzhines si dhe pastertin e çdo individit - pjesemarres ne brigade;

4) Cila brigade ka me pase ma pak mungesa te pa-arsyeshme;

5) Cila brigade ka me e perpunue ma mire dhe ne kualitet materjalin e Kongresit te Peste te PKJ;

6) Cila brigade ka me arrijte rezultate ma te mira ne luftimin e analfabetizmit, d. m. th. cila ka me arrijte ne perqindjen ma te madhe;

Cila brigade ka me e zhvillue koshjencen politike dhe frymen socjaliste ndermjet antareve te shtabeve dhe brigadistave.

Na po i shpallin keto gara - shkruejne antaret e brigades se V-te te Gilanit ne hekurudhen Bellaçevac-Rudnik Kosova - per arsye se eksperienca e deritashme na ka mesue se gjithshka mund te kryhet ne baze te punes so vetmohueshme dhe se jemi te bindun qe nepermjet te garave shkojme me hapa te sigurte dhe vigane kah socjalizmi.

U-formue brigada e III-te e Frontit populluer te rrethit te Prishtines

Ne ndere te Kongresit te II-te te PK te Serbis dhe te Konferences se IV-te Krahinore te Partis, frontistat e rrethit te Prishtines e formuen brigaden e III-te te Frontit populluer. Ne ket brigade marrin pjese 200 antare te Frontit, te cilet kane shkue ne ndertimin e rruges industrijale prej minjeres "Kosova" deri ne stacjonin hekurudhuer Bellaçevc i Madh. Vendin e fjetjes dhe ushqimin e antareve te brigades e ka sigurue sipermarrja e minjeres "Kosova". Gjithashtu ajo u ka sigurue kepuce atyne qe kane qene pa to.

Me rastin e riorganizimit t'aparatit te grumbullimeve forcohet grumbullimi i te gjitha prodhimeve bujqesore

Furnizimi i njerzve punues ne qytete dhe nder qendrat industrijale asht detyre si per drejtorit e grumbullimit lokal ashtu edhe per drejtorite e grumbullimit te Krahines s'one. Rezultatet e deritashme te grumbullimit kane qene te mira. Por ne to jane ba edhe leshime e gabime, e kjo ka rrjedhe nga organizimi i dobet i punes dhe nga moskryemja e detyreve ne lidhje me ket pune. Detyra kryesore per realizimin e planit ne prodhimet bujqesore ka qendrue ne sipermarrjet ekonomike, me gjithe qe keto nuk kane marre pjese direkt ne grumbullim. Realizimi i planit i asht besue kooperativave e sipermarrjeve te rrethit.

Kooperativat, si mbledhsat kryesore, kane qene te ngarkuem me detyre te shumta, e ne mungese te kuadrave nuk kane qene ne gjendje me iu pergjegje grumbullimit ashtu si duhet. N'anen tjeter, kooperativat si dhe sipermarrjet grumbulluese te rrethit e kane mbajte sasin e nevojshme t'artikulve per me i plotesue nevojat lokale t'atij vendi ku asht ba grumbullimi. keshtu qe ka rastle qe kane ra na partikularizmin lokal. Kooperativat dhe sipermarrjet grumbulluese te rretheve gjithashtu edhe keshillat ekzekutive te rrethit, nuk i kane perfshi te gjitha sasinat e tepricave te prodhimit, mosfunksionimi si duhet i rrjetes te grumbullimit nder disa rrethe e ka pengue shum bashkpunimin me organet pergjegjese te grumbullimit, te cilat per kete gja nuk kane mujte me pase nji pasqyre te kjarte mbi punen e rrjetes se grumbullimit. N'anen tjeter, nuk u asht dhane ndihma e duhun sipermarrjeve lokale te grumbullimit, persa i perket pregaditjeve speciale. Kjo gja ka pengue edhe kontrollin mbi dispozitat e fondeve, kështu qe ka ngja shpesh here qe sipermarrjet lokale te grumbullimit kane disponue me fonde simbas gjendjes se tyne, por keto i kane perdore ma te shumten e heres per nevojat te tyne lokale.

Per me e permiresue gjendjen asht nevojite formimi i rrjetes se grumbullimit e cila ka per te qene ne gjendje qe ne menyre themelore me i perfshi te gjitha tepricat e prodhimeve bujqesore dhe te siguroje udheheqjen e drejte te fondeve te prodhimeve te grumbullueme. Perveç sipermarrjeve lokala te deritashme kane me u-krijue edhe sipermarrje grumbullimi speciale republikane nen udheheqjen e ministris se tregtis dhe te furnizimit. Kjo do te baje grumbullimin ne shum rrethe. Keshillat popullore te rretheve kane per t'i dhane ndihme ketyne sipermarrjeve me karakter republikan persa i perket grumbullimit dhe, vazhdimisht kane per te ba kontrollin e gjithaneshem ne punet e tyne. Keshillat, konstatimet dhe vrejtjet e tyne mbi punen e sipermarrjeve republikane kane me ia referue ministris republikane te tregtis dhe te furnizimit, kurse sipermarrjet kane me i ndihmue ne sigurimin e mjeteve te prodhimit, ne gjetjen e kuadrave, amblazhave, ne gjetjen e lokaleve te pershtatshme etj. Tue ngarkue peshen e grumbullimit ne rrjeten e grumbullimit te republikave, kane me u krijue kondita ma te mira e ma te perhiatshme Per forcimin e punes te rrjetave te grumbullimit, e n'anen tjeter do te sigurohet plotesisht mbikqyrja mbi disponimin e drejte te sasive te grumbullume te prodhimeve. Sipermarrjet republikane nepermjet te linjes s'ekonomis tregtare kane me i krye detyret republikane, kurse nepermjet te ketyne dhe t'organeve te qeveris se perbashket, veçanerisht keshillat nepermjet te linjes se pushtetit kane me kontrollue punen e tyne dhe me u-dhane ndihme ne kryemjen e detyreve te ketyne sipermarrjeve qe ndodhen ne teritorin e tyne.

Rrjeta e re e organizueme per grumbullim ka per te dhane rezultate ma te mira persa i perket grumbullimit. Por, per me i arrijte keto rezultate nevojitet pa u-shtye aspak, te merren masat per pagesen e aparatit te grumbullimit per punen e bame dhe n'anen tjeter te shperblehen ata qe kontribuojne ma shum se te tjeret dhe qe korrin sukses ne pune. Garat ne mes te sipermarrjeve duhet te korrin rezultate edhe ma te mira, veçanerisht, ne qofte se keto edhe ne mes te sipermarrjeve tregtare bahen metoda te perhershme puneje.

Per te pase rezultaten sa ma te mira ne grumbullimin e shtazeve, si artikull kryesor per ushqim, grumbullimin do t'a bajne sipermarrjet republikane ne shum rrethe. Sipermarrja ka per te pase ne çdo rreth deget e saja me tregtin e pamvarun ne grumbullimin dhe ne lidhjen e kontratave. Me rastin e formimit te sipermarrjeve duhet me pase kujdes qe keto te formohen neper qendra ku ka ma teper qendra konsumuese-qendra industrijale, keshtu qe perveç detyreve te pergjitheshme ne rend te pare t'i plotesoje nevojat e ketyne qendrave. Prane ministris republikane te tregtis dhe te furnizimit ka me u formue drejtorija kryesore per grumbullimin e gjave te gjalla, e cila do te kujdesohet mbi kruemjen e puneve tregtare te sipermarrjeve tregtare si duhet ne realizimine planeve te tyne. Mandej kjo ka me qene si shitse dhe eksportuese e gjave ne republiken.

Ne teritorite ne te cilat grumbullimi mundet me perfshi ma teper tregje te tepricave te prodhimeve, kane me u formue sipermarrje te specializueme per grumbullmin e pemve, te perimeve dhe per pijet alkoolike. Ne rejone ku ka ma pak tregje tepricash prodhimi, sipermarrjet kane me formue vetem dege ase stacjone grumbullimi me detyre qe te mbledhin tepricen. Grumbullimi i pemve dhe i perimeve per qytete te mdha mundet me u ba nga sipermarrjet e grumbullimit te qytetit ne teritorin e rrethit ase te rejonit qe e ka lejue drejtorija per grumbullim.

Mbasi deri tash qumeshti dhe bylmeti nuk jane perfshi ne grumbulim si duhet, nevojitet qe qumshti te perfshihet ne planin e perbashket te grumbullimit mbasi ai, asht artikull me randesi per ushqimin shoqnuer.

N e t e gjittha republikat popullore, prane ministris se tregtis ashtu edhe prane drejtoratit te tregtis dhe furnizimit te tregtis ne Krahinen t'one kane me u formue ne te parat sipermarrje speciale e ne krahinen t'one qendra per grumbullimin e sasive te nevojshme te qumshtit dhe per perpunimin e tij, ne menyre qe te k e m'i ne tlyen, djat, kos etj., te cilat munden me i ba stacjonet ne rrethet e tyne. Per furnizimin e qyteteve te mdha persa i perket grumbullimit te qumshtit kane me u formue sipermarrje per grumbullimin e tij, te cilat simbas planit i cili do te bahet ne mbeshtje te nevojave kane me e krye grumbullimin e qumshtit nepermjet te rrjetes se tyne nder rejonet e caktueme. Per sipermarrjet e qytetit ka me grumbullue sasina qumshti edhe aparati kooperativ i grumbullit.

Grumbullimi i shpenve dhe i vove ka tregue deri sot rezultatet ma te dobta, natyrisht nga rrjeta e dobet e grumbullit. E, sipermarrjet speciale qe do formohen ne rrethe ku ka kondita dhe mundesi, do te bahet grumbullimi, mbajta dhe rritja e tyne. Keto sipermarrje republikane perveç grumbullimit do te formojne edhe stacjone per selekcjonimin e tyne. Keto, shpezet kane per t'i rrite ne kondita ma te mira, keshtu qe prej kendej do te furnizohen kooperativat punonjese katundare. Kooperativat bujqsore, ekonomit prane sherbimit te furnizimit te puntorve dhe te nepunesave, te pasunive bujqesore shtetnore, ekonomit e qyteteve e tjera, Sipermarrjet kane me krijue dhe ferma per shpese, n'afersi t'e qyteteve dhe qendrave te medha industriale, nepermjet te cilave kane me e furnizue me mish dhe voe popullsin e qytetit.

Me nji organizim te tille te rrjetes se grumbullimit, ky do te bahet shum ma ne rregull dhe rezultatet do te jene ma te kenaqshme se sa kane qene deri sod. N' anen tjeter do te shkarkohet mjaft nga barra e rande qe ka pase deri tash sektori kooperativ, i cili ka detyra te medha ne rekonstrucjonin e bujqesis. Nepermjet te sipermarrjeve grumbullimi ka me u krye ma me plan, e kjo do te thote qe do te grumbullohe keto sasina nga tregjet qe shesin teprica te prodhimeve bujqesore.

Vneshta Savrove-Sopin ne rrethin e Suharekes

Me 30 nanduer te ketij vjeti filluen punimet ne formimin e vneshtes Savrove-Sapine, e cila ka nji randsi te madhe n'ekonomin e ktij rrethi si edhe ne Krahinen Autonome te Kosmetit. Populli i Suharekes tue kuptue me te vertete randesin e zhvillimit t'ekonomis ne vendin t'one, e cila asht nji nder piket ma kryesore te Planit te pare pesvjeçar, i asht pervehe punes me vetmohim, dhe me te gjitha pengesat e ndryshme, te kohes se veshtire, te tokes se forte, dhe ndoshta te mungeses se duhun te mjeteve te ndryshme per shpejtesimin sa ma te shpejte te punes, çdo dite e ma teper i realizon dhe i kalon normat dhe premtimet ne punimin e kesaj vneshte. Kjo vneshte asht parapa te kryhet me nji siperfaqe prej 15 hektaresh dhe te gjitha punimet kryhen vullnetarisht nen inisjativen e Frontit popullaer te ketij rrethi. Ketu marrin pjese puntoret prej te gjitha keshillave te vendeve te rrethit Suhareke, dhe numri i puntorve ne ket vend, shp-sh here mbrin deri ne 400 vete, gja qe verteton se keshillat e vendit te Suharekes duen me te vertete jo veç me i plotsue por edhe me i tejkalue normat dhe premtimet e dhanuna deri ne Kongresin e Dyte te PK te Serbise, ne punimin e kesaj vneshte. Mbas 10 dite pune, ç'prej fillimit te kesaj vneshte jane falenderue 16 vete sulmuesa per aftesin dhe vetmohonin e tyne ne pune. Jane dallue ma se forti antaret e Frontit Spasa Petroviq, i cili ko kallue normen 148 per qind nga Mushutishti, Hasan Izeti nga Samadraxha e ka tejkalue normen 148 per qinde.

Punen e kesaj vneshte e organizon Sajdi Kuqaka, referent i bujqesise per rrethin e Suharekes.

Nder keshillat e vendeve jane per t'u permende per ndihmen e tyne te mire, Duje, Mushutisht, Sopine, te cilat dergojne mjafte puntore t'aite per pune ne sa ne kete pikpamje dallohet ma i dobet Keshilli i vendit Suhareke.

Ndoc Deda

Premtimet e rrethit te Drenices per Kongresin e dyte te PKS

Ne ndere te kongresit te II-e te PK te Serbise dhe te konferences se IV-te Krahinore te Partis, rrethi i Drenices ka marre persiper qe deri ne diten e Kongresit t'i plotsoje premtimet si vijon:

do te tejkalohet plani i parapame i lavrimit sa ma te thelle i tokes, se do te mblidhen me kohe te gjitha tepricat e drithit, do te perfshihen ne kurset analfabetike te gjithe analfabetet, prej tecilve do t'aftesohen ne lexim e shkrim 20 per qind, do te hapen kurse t'alta arsimore ne çdo keshill vendi do te mbulohen shtepijat e shkatrueme nga okupatori, do te sigurohen drute per te gjitha shkollat e ketij rrethit, do te mbulohen tri shtepija kooperative, dy shkolla do te plotesohen me banka te reja, asht formue brigada e punes prej 100 antaresh te Frontit do te perpunohet materjali i Kongresit te Peste te PKJ ne çdo keshill vendi e katund do te pritet dhe transportohet sasija e parapame e druve ne pyll per keshillin popullaer te rrethit dhe per organizaten e gruas, dhe se do te paguhet antaresija e Frontit 100 per qind deri ne fund te ketij vjeti.

Shperblim dhe lavdrim shoferash per plotesimin e planit te ketij vjeti para afatit te caktuem

Kolektivi puntor i sipermarrjes s'autotransportit ne Peje e ka plotesue planin e ketij vjeti qysh me 18 nanduer dhe e ka tejkalue detyrimin e transportimit t'udhetareve ne detyrimin e transportimit te mallit pet 20 per qind, Gjate perpjekjeve per realizimin e ketij plani, kolektivi e ka kursye landen djegese, per 4,3 per qind.

Ne diten e kryemjes se planit vjetuer jane lavdrue dhe shperblye shoferat te cilet kane punue disa ore ma teper se e punen e caktueme, ata qe jane angazhue dhe kane kontribue ma shum per plotesimin me sukses te ketij plani. Perveç te 15 te lavdruemve, jane shperblye dhe lavdrue Petar Filipoviq, Rexhep Busali, Milladin Raduneiq, Vuketa Gruzderoviq, Bajram Dresheviq, Arse Gojkoviq dhe Fuat Malushagiq.

Ne ndere te Kongresit te dyte te PKte Serbis, kolektivi puntor i kesaj sipermarrje po zhvillon gara te gjalla. Ka marre detyrime te reja per ruejtjen e mjeteve motorike dhe paksimin e premtimeve per 17 per qind, ne tejkalimin e tom-kilometrave te plota per nji automobil ne 21 per qind ma teper prej normes se parapame deri tash, ne paksimin e ndalimit te panevojshem t'automobilave ne ngarkim ne 12 per qind, ne kursimin e landve djegese dhe lyese ne 6,5 per qind ma teper nga norma e parapame, ne kursimin dhe ruejtjen e gomave ne 14 per qind dhe ne permiresimin e disiplines se punes ne 12 per qind. Perveç ketyne detyrimeve kolektivi asht zotue se do t'a shtoje parapagimin ne shtypin t'one ne 25 per qind dhe se do t'a formojne dhomen e defrimit.

Per realizimin e planit te kontraktimit te lules se diellit

Ne Krahinen t'one asht tue u-ba kontraktimi per mbjelljen e lules se diellit. Deri tash ne gjithe Krahinen t'one plani i kontraktimit per mbjelljen e kesaj bime industrijale asht realizue ne 41 per qind.

Ne saje te perpjekjeve per spjegimin e drejte bujqve, sidomos per randesin e lidhjes se kontratave dhe ne saje te ndihmes se madhe qe u japin kooperativat bujqesore dhe keshillat popullore organeve te cilat merren me kontraktim, ne shum rrethe jane mbrrij te rezultate te knaqeshme. Keshtu per shembull ne rrethin e Drenices dhe te Suharekes plani i kontraktimit te lules se diellit asht realizue me 101 per qind, mandej ne rrethin e Rahovecit me 80 per qind dhe n'ate te Prishtines ne 60 per qind.

Rezultate te dobta jane arrijte ne rrethin e Gilanit, te Podujeves dhe n'ate te Ferizajt, nderse ne rrethin e Pejes, Istokut dhe te Gjakoves ende nuk ka fillue kontraktimi per mbjelljen e lules se diellit.

Kooperativat bujqesore, bashkimet e rretheve dhe keshillat popullore nder keto rrethe, asht e nevojshme qe t'angazhohen ma teper per realizimin e planit te kontraktimit.

Prodhimi i magnezitit ne minjeren e Drenices

Ne minjeren e magnezitit te Drenices kolektivi puntuer e ka plotsue planin vjetuer te prodhimit te magnezitit te papunem 37 dite para afatit, kurse me 10 te ketij mueji dega per pjekjen e magnezitit e ka plotesue planin e vet.

Ketij kolektivi i ka sjelle veshtiresina te mdha ne plotesimin e ketij plani largesija nga hekurudha, neper te cilen transportohet ky lloj minerali. Ajo asht larg minjeres afer 13 km. Me çfrytezimin e drejt te mjeteve transportuese dhe me meremetimin ne kohe te rrugeve deri ne stacjonin hekurudhuer, kolektivi punonjes i minjeres se magnezitit ne Drenice ka mbrrijte qe t'a plotesoje planin vjetuer para afatit.

Rreth ndertimit te shtepijave kooperative ne Gjakove

GJAKOVE:

Siç dihet, ne rrethin e Gjakoves mbrenda ketij vjeti filloi ndertimi i 13 shtepijave kooperative, nga te cilat njena asht pertej planit. Ne punen e deritashme per ndertimin e ketyne shtepijave, ky rreth ka mbrrijte rezultate ma te mira ne Krahinen t'one. Deri tash jane perfundue plotesisht dy shtepija kooperative e ne 11 tjerat po vazhdojn me hov punet perfundimtare.

Arsime e kulturë

NGA LUFTA E ANALFABETIZMIT NE KRAHINEN T'ONE

Perpjekjet dhe roli i organizatave masovike per luftimin e analfabetizmit ne rrethin e Iztokut

Ne rrethin e Iztokut lufta kundra analfabetizmit ka mbrijte tash ne fazen perfundimtare. Te gjitha organizatat masovike, veçanrisht organizatat e Frontit popullor dhe te rinis popullore po bajne perpjekjet ma te madha per mbledhjen e te gjithe analfabetve ne kurset analfabetike ne rreth, te cilet jane prej 14-45 vjeç. Deri me 12 te ketij mueji ne 264 kurse analfabetike jane mbledhe ma se 2.200 analfabete prej gjithe shumes se 3.320 ne tan rrethin.

Perveç kesaj, mbas çlirimit ne ket rreth i asht kushtue kujdes i madh edhe perfshimjes se femijve ne shkollat fillore. Nder sa ne Jugosllavin e vjeter rrethi i Iztokut ka pase vetem 9 shkolla, sot i ka 21. Ne Jugosllavin e vjeter ka qene nji numer i vogel shqiptaresh dhe shqiptareve qe dishin me shkrue e me lexue ndersa sot ky numer asht shtue mjaft.

Antaret e Frontit te rrethit t'Iztokut po mattesohen ne nivelin kulturalo-arsimuer edhe nde [illegible] mjet te kurseve arsimore, ne te cilat tash jane perfshi ma se 300 serb dhe shqiptare. Ne rreth punojne edhe 147 grupe leximi ne te cilat jane perfshi dy mije shqiptare dhe serb.

PODUJEVE:

Ne rrethin e Podujeves, deri tash, nuk i asht kushtue kujdes i duhun luftes kundra analfabetizmit. Pushtetet arsimtare dhe organizatat masovike nuk jane angazhue aq sa duhet ne punen per hapjen e kurseve dhe mledhjen e personave analfabete. Deri tash kane punue vetem tridhete kurse analfabetike me 415 ndjeksa, prej te cilve 289 shqiptare. Ne ditet e fundit ka fillue akcjoni qe te perfshihet numri sa ma i madh i personave analfabete ne kurset analfabetike.

VUÇITERNE:

Deri me 5 te ketij mueji ne rrethin e Vuçiternes jane formue ma se 190 kurse analfabetike, ne te cilat jane perfshi 3.526 persona analfabete, prej te cilve 2.796 mashkuj dhe femna shqiptare.

GILAN:

Ne fillim te ketij mueji, ne rrethin e Gilanit kane pune 96 kurse analfabetike per gra, prej te cilve 74 jane per gra shqiptare. Ne kto kurse jane perfshi 685 shqiptare dhe 504 serbe.

DRAGASH

Ne kurset analfabetike te rrethit te Dragashit jane perfshi deri tash 2.563 analfabete.

PRISHTINE:

Ne kuadrin e pregaditjeve per festimin e 22 dhetorit - dites s'Armates Jugosllave, u-mbajt ne Prishtine ligjerata: "rruga luftarake e Divizionit te III-te sulmues gjate luftes s'one Nacjonal - çlirimtare". Themen e mbajti shoku Viktor Kuçan, nenkolonel i Armates Jugosllave.

Ne ligjerate muer pjese nji numer i madh qytetaresh dhe luftetaresh.

Puna ideo-politike dhe kulturalo arsimore te brigaden e II-te Frontit popullor te rrethit te Prishtines

Ne brigaden e IIte te posaçme te Frontit popullor te rrethit te Prishtines, e cila punon ne ndertimin e hekurudhes industrijale minjera Kosova—Belaçevc i madh, i asht kushtue kujdes i duhun punes ideo-politike dhe kulturo-arsimore. Çdo dite lexohen lajmet politike nga shtypi i dites dhe perpunohet materjali tjeter politik me brigadistat. Jane formue edhe dy kurse analfabetike, ne te cilen jane perfshi 28 brigadista analfabete. Gjithashtu, jane formue 6 grupe leximi, me punen e te cilve jane perfshi gjithe brigadistat. Ne keto grupe perpunohet materjali nga Kongresi i peste i PKJ, fjalimeve te ndryeshme dhe referatet e udheheqesave t'one.

Sigurimi i orendive shkollore ne rrethin e Drenices

Me inisijativen e Frontit popullor te rrethit te Drenices u-terhoqen nder keto dite 60 metra kubik drrasa nga sharra e Koleshinit ne Serbice. Antaret e Frontit nuk u kursyen aspak per me i vue ne sherbim kalshet e veta terhekse per ket transportim. Keto drrasa kane fillue te hyejne ne perdorim qysh me 14 te ketij mueji, me te cilat po ndertohen bankat e reja per shkollat e ketij rrethi, e ne radhe te pare per gjimnazin serb dhe shqiptar e, per te tjerat shkolla me radhe.

Nga kjo shifet se populli i rrethit te Drenices e ka kuptue mire randesin e arsimit prandaj nuk kursen asgja per te miren e brezit te ri-ardhmenis se sigurte te Vendit t'one. R. SH.

Ligjerate per ushtaret e demobilizuem

Ne sallen e oficerave u mbajt keto dite nji ligjerata per ushtaret e demobilizuem. Ket ligjerat e organizoi keshilli i rrethit sindikal te Prishtines. Si referues qe shoku Asllan Fa[illegible], i cili foli mbi themen „Ushtaret e demobilizuem ne ndertimin e Socjalizmit ne Jugosllavin e Re te Tito".

Shoku tue fole mbi karakterin e ri t'Armates Jugosllave, theksoi se Armata e Jugosllavis, s'asht vetem vendi ku mesohet arti ushtarak por edhe vendi ku mesohet menyra e ndertimit te socjalizmit. Ne te ushtaret t'one edukohen dhe kalitne me frymen revolucjonare, me frymen e lufte[s] per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one dhe me frymen e lufte[s] per shtypjen e elementave kapitalista ne katund dhe per zhdukjen definitive te kapitalistave ne qytet. Gjithashtu shoku theksoi se ushtaret e demobilizuem e kane per detyre me kene ne radhet e para per ndertimin dhe ngritjen e ekonomis s'one.

Ligjerata asht ndjeke me shum vemendje prej ndigjuesave.

Ne ket ligjerat kane asistue nder 200 ndigjues.

Njisit' e garnizonit te Prishtines ne gara para festes s'Armates Jugosllave

Para dites se festimit te 22 dhetorit-pervjetorit te shtate te themelimit t'Armates s'one te lavdishme-njisit e garnizonit te Prishtines kane mbjelle rreth kazermave te tyne 1.07,465 fidane bagremesh. Gjithashtu edhe disa njisi t'Armates Jugosllave ne Prishtine, Peje, Prizren dhe ne vendet e tjera te Krahines s'one u-kane ndihmue organizatave te Frontit popullor ne pyllizimin e shoqinave. Ne ket akcjon njisinat e Armates Jugosllave kane mbjelle 20.000 cope fidane te ndryeshme pyjore. Perveç asaj grupi prej 100 oficerave dhe nen-oficerave te garnizonit ushtarak te Prishtines se bashku me ekipen e orkestres ushtarake e kane vizitue kooperativen katundare bujqesore "Nji Maj" ne Devet Jugoviq dhe kooperativen katundare punuese te formueme tash ne Bernicen e Poshtme. Grupi ne fjale ka egzekutue programe te koncertit dhe kooperativistave iu shperndau nji sasi librash - si dhurate. Ky grup e vizitoi minjeren e qymyrit «Kosova» dhe dha nji theme e koncert ne mbramje per minatoret.

Ne disa qendra te Krahines s'one oficerat e Armates Jugosllave kane mbajte ligjerata mbi formimin dhe zhvillimin e njisive t'Armates Jugosllave gjate luftes Nacjonal-çlirimtare si dhe mbi sukseset qe kane korre ato gjate perpjekjeve per me e çlirue Vendin t'one nga okupatori nazi-fashist dhe nga trathtaret e Vendit.

Fragamente nga ditari i Dyl Tahirit

Akcioni i pare i guerileve

„U muerrem vesht pra — tha Dyli tue dashte me e perfundue bisedim — Bujku me grupin e pare [illegible] kendej Prontit, un me grupin e dyte andej Prontit e Guri me grupin e trete prej fushave e [illegible]. Ti Emin te pregatitish pra [illegible] e te [illegible] heti ne sy. [illegible] e Bairo [illegible] e [illegible]... Ne [illegible] sahati fillon puna. Dhe nji gja [illegible] se [illegible]: Proklamatat [illegible] [illegible] qe te [illegible] lagen dhe fishomi ne [illegible] — [illegible] akcioni e [illegible], [illegible] [illegible] gjate [illegible] [illegible] pra. Tash me punet [illegible] Vdekje fashizmit — Liri popullit!„ i thane njeni tjetrit [illegible] e shpernadaat. Me [illegible] perngjesoje per me entusiazmin te [illegible] [illegible] e nja [illegible] ne [illegible] e [illegible] guerriljen e vet.

Mbramja e 30 Prillit. Neser Nji Maj. Komiteti Qendror nxe proklamaten e vet i thirre te gjithe antaret e partis Komuniste, te gjith punetoret, krejt popujt e Jugosllavis qe te luftojne ne luftë per jete o per vdekje kundra okupatorit fashist, te forcojne radhet e veta edhe ma teper te sulmojne kudo qe te jone. Tani e rande ju ka ra komunistave, me qene ne balle te luftes, nuk asht thjeshte. Emini, Dyli, Bojku edhe Guri kane vendos qe, me guerriljet e veta, perveç shperndamjes se proklamatave, te presin edhe lanet e telefonit. Duhen provue keto guerrilje qe jane formue.

Qrambull mendimesh pershkojne trunin e secilit. Si do te kaloje guerrila e jone sonte? Sigurisht do t'a kryejme detyren me sukses!

Dyli shtrengon kepucet, vesh pallton, shtie revolen e tute ne shoke, lambet ne shtep kap nen krah tupin e proklamatave dhe niset tue e rrugen me shpejtesi. Pikepjekja me „vendin asht ne rruge te Barakut n'ora nandi pa nji çerek.

„Musa, a kane ardhe te gjithe"? —„Ju mungojne ata tre te rijt". S'ka gja — tha Dyli — po ndahemi nga tre. Ti Musa me Morican e me Dragutinin merrni lene top, 500 cope, prej Namazgjahut deri ne Fusha. Ti Mazllum me Dinin, me Shaqen merrni mahallen prej mehalles se magjupve, rruges se Sefes, mehalles Kusarve e do te mbarosh te ura e Tallqve. Na ka tre po marrim prej Namazgjahut e furres se Kamber ekmekxhis, deri ne rruge te Sefes e te kroni i Panchalles.

Keni kujdes te madh! I gjall kush s'duhet me ra ne dore! Si te kryejme punet do te mbidhemi te tyrbja e Sheh Fetahut! Parollen e dini,

9 sahati. Ne te gjitha rruget e qytetit te Gjakoves fillojne guerilat te leshojne proklamata neper shtepijat e qytetarve. Edhe neper kamande shperndahen sonte. Keto fleta „te mallkueme" si thue reakcjoni, i kallxojne popullit rrugen e drejte, e zgjojne nga gjumi dhe e nxjerrin nga fillqtija ku jane tue e shtie trathetaret e poshter.

Dhete e gjyse sahati. Treshja e Dylit leshoi proklamatat e fundit te Medreja e vogel. S'ka shtepi ku te mos jete leshue nji proklamate.

Me pritni keiu pak shoke, per pese minuta un vij. Ne kalofte kush mahi funi ne Taphone, mos i bani za, dhe u zhduk Dyli tue llaparçite lloçen me hapa te shpejta.

Tak, tak, tak, cakati ne dere te Bakallit. Avdija me rrushin e vet qe perqjojshin te dera, duel „A kryet? — Po! hajdeni. Avdia kishte sakica, tri sharra te mdha e tri palë dana. I muerren shoket te ura e vazhduen te shpejtonjne neper lloçet e rrugve te Gjakoves, kah vorret e mdhaja te tijat e Dylit e te Tyrbja. Tri hije shtrime pemet e Tyrbes thelle kah arat kerkojne parullen. Dyli njofti zanin e Mazllumit.

„Vdekje fashizmit — Liri popullit! Si shkon puna shoke"?

„Fare mire pergjegji Mazllumi. I shperndame me rregull te gjitha"! — Po keto pushke? pyeti Dyli. „Te tre fillojne me qeshe". Tue dale prej rruges se Dervarve befas hasem ne dy polic. Keta fillojne m'u shmange (kallxoi shoket) un nxorra revolen dhe iu afrova policve. Mos luni ne dajt jeten, ju thash, tue ju futë revolen afer. Mbeten si te shtengueme. Duert perpjet! I çarmatosa te dy por ç'e da! Revole s'kishin pase i hengeri drejt. Ju dhash dhe nga nji proklamate dhe ju kercnova qe te heqin dore nga policija por kot s'heqin dore lahperaf sahan lepiesa. Ishin pi e ishin ba tupe pijancat e fllliqet. Dhete hapa larg u vinte era! Dhe tue qeshe Mazllumi vazhdoje — Sigurisht nuk me kane njofte, kane me thane se ti Dyl e ke ba ket pune Krisi gazi.

Po, „ma mire me te dale shpirti se me te dale zani", tha Dyli tue qesh dhe i mueer pushket mu i pa.

— „Qe po vjen edhe grupi tjeter si debet shtrihemi. Ç'na kallxojne keta n thue"?

— He Musa ku e ke te tretin? —

— „Nuk e dij se ç'u ba. te kafja e Madhe u hasem me nji patrolle, tre karabinjere e dy police. Thash te kalojme. Por Nazmi Begut ju duken te dyshimt e ndhassi kaluem i tha karabinjerve qe te na ndalin. Ne fillueme me ik. Ata te na vorru nji batare pushke. Hall me qene i gjate more vlla, nja gjashte—shtate here jam rxue tue ik. Aty nuk e dij se ku na u nda. Sigurisht ka shkue ne shtepi. I ri more vlla., i dhimbet jeta. Aman keto kepucet e llastikut ma kane hanger shpirtin tue rrshqit neper kete lloç. Pe nejse t'i lame keto!„ — Mire e ke — ia priti Dyli, te fillojme kete tjetren.

Ti Brahim dhe ti Lele shkoni te ura e Llukacit e mos leni njeri qe te vij kendej. Ti Mazllum shko te ura e Nakaralles. Ne po fillojme ketu punen.

Ju tre merrni sharren, sakicen edhe danat, filloni prej ketuhit e teposhte. Qe edhe ju te tre merrni e filloni prej ketu, deri te kroni i Shkjaut. Ti Xhevdet merrni keta tre e fillo prej kroni, e deri te ura. Hajde ne pune: shtyllat e telefonit preni dy heresh: ne rranze dhe ne mjedis, telat s'ma shkurte qe te mos mujne me i perdorue ma. Un me sakice do te vi me rend te secili.

Reit grumbujt shkeputen prej majes se Shkelzenit e te Gjeravices e me shpejtesi vrapojne kah Pashtrikut e Shari. Hana siper Pashtrikut ngel tue u mahef nder re e tue dale persert i pergjigjet ushtarit qe ne pyll e ka zane vonu dhe prej friges e josh shtepija dhe oda e madhe. Qetsi. Nji qyqe kendon larg. Nji i Llukacit ushton. Asht rrite. Duket se ne bjeshke ka ra shi i madh. Prej pronit, Llukacit e Ereniku me mija zane bretkosash ushtojne e bajne nji zhurme te çuditshme si te dojshin me lajmue se diabka e re do te behet sonte. Ne menden e çdo guerristi pershkohet nji frige e perzieme me gezim, me enthuzjasem. Here i duket vehtja ma i madh, ma i zoti, here e mbulon te ftohit. Sigurisht nga friga. I del vehtja çelit. Çudi e madhe po pse gjith kjo frige? Asnjeni prej ketyne nuk ia ka lu punes me dy mendje. Ne sy u shndrite vendosmenija. E si me e spjegue kete? Asht pergjegjesija qe i shtin me u frigue.

Trimnija dhe friga, jeta dhe vdekja, pa-eksperienca dhe deshira jane perzie dhe pershkojne trunin e secilit. S'asht çudi. Akcioni i pare Musaja del per te paren here ne fushe natën.

Grithja e sharres mbi landet prish heshtjen dhe monotonin. Landa e pare bjen ne toke. Ushtime e madhe. Gjith telat tingllojne dhe bajne nji zhurme te çuditshme. Sa shum po rapiteckan, do te na ndiejne italjanet e mos po na vjen me tankse llot secili me vedi. Ra landa e dyte, e treta, e katerta.... Qetsija u thye. Zhurme e madhe. Puntoret u-enthuzjazmuen. Marren kuraje. „O Musa! O Dyl! O Avdi! O Dragutin!" — fillojne t'i thrasin njani tjetrin prej se largti—"sa mire u-rxue-kane. Kqyr se disa po dilkan edhe me rraje e mandej ma kollaj me i shkurtue ne dysh". Dyli si triumfuesi me sakice ne dore e plot gezim shkon prej landes ne lande tue i thye filxhanat. U ndihmon shokve. Lande e shkurtueme i çojn ne vlade.

3 sahati mbas mjesnate. Prej ures e n'ure landet u prene: tridhete e nji. Guri kishte dale edhe pertej ures. Prene kater lande.

Nji pushke krisi te Tyrbja. Asht shenji per mu mbledh. Dylit ju kane ba duert gjak. Bishti i sakices ia ka vra. „Medet qe s'kemi dinamit ia priti Bujku se do t'i kishim prish edhe keto ura". Mjaft ma — iu pergjegj Brahimi — ti s'po ngihesh kurre. Te nisemi per baze se qe duel sabahu e shoket duhet t'i marrojne teshat per me dale ne pune.

Te perlloçun, te lodhun, te rraskapitun por te mbushun me gezim e me bes'm ne vehten ecin tue qeshe, tue kallxue se cili ka rxue ma shum, cili e ka pre ma shkurt telin. Secili e ndien vehten ma trim, ma krenatie, ma te lehte, ka fitue ma teper besim ne vehten e vet. Kenaqesija, autoriteti dhe gezimi i triumfuesit shprehej ne fetyren e ne fjalet e çdonjenit.

Akcjoni i pare u—krye mire. Kemi me e festue diten e nji Majit.

Lajme nga bota e jashtme

Mbas mbyllies se pjeses se pare te seances se III-te te Asamblies se pergjithshme t'OKB

Seanca e III-te e Asambles se pergjithshme do te hyeje ne historin e Kombeve te Bashkuem si hap i ri per shkeljen e principeve te Hartes nga ana e blokut anglo-amerikan

— Tha ne fjalimin e vet perfundimtar shefi i delegacjenit Sovjetik A. Vishinski —

Korespodenti i „Tanjugut" nga Paris lajmron:

Asambleja e pergjitshme e k[a] krye punen e vet te pjeses se pare te seances se trete ne Paris. Plenumi i asambles se pergjitheshme e kreu sessionin e fundit me shkeljet e reja te principeve themelore te hartes s'OKB-lue e pranue diktatin amerikan ne lidhje me çashtjen e Kores d. m. th. te rezolucioneve mbi Koren, te cilat i propozuen Shtetet e Bashkueme t'Amerikes, Kina dhe Australija.

Gjate debates ne plenum perfaqesuesit e Bashkimit Sovjetik, Jugosllavis, Ukraines, Bjello Rusis, Polonis dhe Çekosllovakis i vuen damken sistemit te diktatit, te cilin po e zbaton, nen presjonin e delgacjonit SH. B. A. shumica n'Asamblen e pergjitheshme, n'interes te realizimit te planeve imperjalistave amerikane ne lidjen e largme.

Fjalimi i Dr. A. Beblerit

Me njihere para se te vehej ne votim rezolucjoni i SH. B.A mbi Koren n'emen te delegacjonit te Iugosllavis e muer fjalen ndihmesi i ministrit te punve te Jashme te RFPJ Alesh Bebleri. Ai ne fjalimin e vet ne mes te tjerash tha:

„Çashtja qe shtrohet para nesh çashtja e Kores-ka ngajshmeni te madhe me çashtjen greke mbi te cilen tashma kemi diskutue ne ket seance. Ne Kore, si dhe ne Greqi, egzistojne fuqit e armatosuna te bllokut anglo-sakson Si ne njanin asht dhe ne tjetrin vend bloku anglo amerikan ka krijue regjime te cilet reflektohen ne terror, si ne njenin ashtu dhe ne tjetrin vend shofin krijimin e bazave ushtarake te SH. B. A. kundra Bashkimit Sovjetik, si ne njenin ashtu dhe ne tjetrin vend shofim rezistencen e popullit dhe te levizjeve demokratike kundra nderhyemjes se huej dhe perziemjes anglo-amerikane ne punet e tij te mbrendeshme. Mirepo, shumica n'asamblen pergjitheshme, si ne njenin ashtu dhe ne te tjetrin rast imponon diskusjone, te cilat duhet t'a aprovojne nderhyemjen amerikane dhe perziemjen ne punet e shetit tjeter."

Dr. Bebleri mandej tregoi se shtruemja e ketille e çashtjes asht ba tipike n'OKB, sepse-thote Bebleri, ajo qe na paraqitet si „çashtje" nuk asht nderhyemja amerikane dhe prani e trupave amerikane-gja qe ne realitet asht çashtje-por rezistence kundra nderhyemjes persa i perket „çashtjes" greke, qe asht shtrue n'ate menyre qe rezistenca e popullit grek te tregohet si jo greke, si rrjedhim i influences se fqijve dhe keshtu patriotet greke te shpifen si agjenta te huej dhe si kolona e peste. Dishka e ngjajshme po ngjane edhe ne çashtjen e Kores. Komisjoni qe po formohej ka per qellim simbas paragrafit te katerte te rezolucjonit me e zgjanue pushtetin e Kores se Jugut, d. m. th. te policis amerikane, ne Koren e veriut, dhe me e zgjanue ne veri pushtetin e qeveris „parlamentare" te Kores se jugut, e simbas paragrafit shtate, tete dhe nande te rezolucjonit ftohen shtetet antare t'OKB per me i dhane çdo perkrahje qeveris marionete t'imponueme te Kores se jugut dhe me izolue qeverin demokratike te Kores se veriut Qe se si rezolucjoni e „zgjidhe" çashtjen e Kores. Qe prova e kjarte se çashtja e Kores asht shtrue perse mbrapshti. Kjo menyre e shtruemjes se çashtjes per se mrapshti, vashdoi delegati Jugosllav-ky zakon qe te diskutohen „çashtjet", te cilat nuk jane fare kurrfare çashtjesh u sjelle dam te madh kombeve te bashkueme ne syt e opinjonit botnuer. Mbassi kjo seance e kombeve te bashkueme ka dekorue nji numer te madh te ketyne „çashtjeve" - mund t'i numrojme ma se pakti 16, prej "vetos„ deri ne problemet familjare te diplomatave te Çiles dhe nga ana tjeter deri ne zgjidhjen e problemave reale dhe t'energjis atomike dhe te çarmatimit—kjo mbledhje e pergjithshme gjenerale e Shteteve te Bashkueme ka deshprue shum opinjonin e jashtem. Nuk na ka ndihmue ajo qe ne vende te marreveshtjes i kishin pruem deklarimin mbi marreveshtjen (mendoj ne rezolucjonin e Meksikos), ne vend te bashkepunimit dokument mbi metodat e bashkepunimit (propozimi i "asambles se vogel„. Deri ne çmase kjo mbledhje ka deshprue opijonin botnuer asht tregue ma se forti personi komedjante i cili reklamon qeverin e botes", gja e cila nuk munde te kuptoket ndryshe vetem se qeverija amerkane me autorizimin botnuer ne nji moment ka ngrehe mbas vedi kujdesin e madh se sa mbledhja e Kombeve te bashkueme, mbasi ky person jo serioz ka perdore demagogjin pacifike, ketu Bebleri ka mendue per amerikanin Devis, i cili tash ne France propagandon „qeverin botnere" ku shtypi reakcionar i perendimit ne kohet e fundit bane reklama te mdha(ky asht shenji serioz - ka theksue delegati i RFPJ. Na padyshim gjate proçesit te mbledhjes kemi shkatrue nji pjese te madhe te kapitalit moral. te cilin e kemi mbrrijte ne Sanfrancisko dhe ne disa vendime pozitive gjate tri vjetve te mbasluffes.

Sot, e kepusim mbledhjen per tre muej.

Per keta tre muej te nderpremjes se kesaje pune, zotni te shumices, kishte me qene e dobishme qe te mendoni mbi ate çka punon. Mos mendoni mbi tekstet te cilat flasin mbi mareveshtjet dhe bashkpunimet, por mbi bashkimin dhe bashkpunimin. Popujt e juej kete lypin prej jush.

Rezolucijonin amerikan nga mashina Perendimore e votimit e kane votue 48 votuesa kundra 6 votave te delegacijoneve te vendeve sllovene. Delegacijoni i Suedis nuk ka votue.

Mbas votimit te rezulucjonit t'Amerikes, kryetari Evat asht mundue me konklidue mbledhjen, tue mos permende qe rendin e dites se plenumit gjindet edhe projekti i rezolucjonit te Bashkimit Sovjetik ne te cilin kerkohet heqja e komisjonit te paligjesuem dhe te perkohshem per Kore. Shefi i delegacjonit Sovjetik Vishinski tue shpreh çudin kundrejte qendresse se kryetarit Evat. ka deklarue me gjithe te drejtat, qe ka çdo delegat, me i parashtrue plenumit te rezolucjonit kryetari Evat ne momentin e fundit asht mundue me anulue projektin e rezolucjonit Sovjetik dhe te mos paraqitet ne votime. Ne emen te delegacjonit Sovjetik, Vishinski me kambengulje ka protestue kundra qendrimit te tille te kryetarit Evat dhe ka kerkue qe rezulucjoni Sovjetik te hidhet ne votime.

Perfundimi i fjalimit te A. Vishinskit

Gjithashtu edhe shefi i delegacionit Sovjetik Vishinski ka marre fjalen dhe ka deklarue se delegacioni Sovjetik nuk asht ne dakord me levdatat e atilla ne pikpamje te rezultateve te mbledhjes se pergjithshme gjenerale. Vishinski ka konstatue se shumica e delegacioneve tue i pengue delegatet e Shteteve te Bashkueme te Amerikes dhe te Britanis se Madhe kane pengue mbledhjen e pergjithshme gjenerale te marri aso masa qe u duhet me marre me qellim te perforcimit te paqes dhe te sigurimit te popullit. Vishinski ka theksue se asht shumica qe kane hjedhe propozimin Sovjetik ma te randesishem, - mbi ndalimin e armes atomike dhe paksimin e armatimit per nji te treten e pese shteteve te mdhaja - e cila eja shprehe aspiratat e miljona njerzve prej gjithe njerzimit paqedashes. Shumiça kane refuzue propozimet Sovjetike per arsye se ajo nuk u pergjigjen planeve te bashkpunimit nderkombetar, te cilet predoqoine luften e re kundra Bashkimit Sovjetik dhe vendeve demokratike popullore.

Vishinski ka perfundue tue thane se mbledhja e trete e pergjitheshme gjenerale ka me hy ne histori te kombeve te Bashkuem si hap i ri ne shkeljen e principeve te Poveles nga ana e blokut anglo - amerikan nen kryesin e shteteve te Bashkueme t'Amerikes, i cili ka si rezultat vetem dobesimin e bashkimit nderkombetar.

Pjesa e dyte e mbledhjes se trete te pergjithshme gjenerale ka me fillue me 1 prill te 1949 ne Seige Saksesu.

Plani ne perfshimjen e fuqis punonjese ne Krahinen t'one ne ket vjet asht tejkalue me 13, 45 per qind

Ne Krahinen t'one jane korre sukseses te dukshme rreth perfshimjes se fuqive puntore ne dege te ndryeshme t'ekonomis s'one. Plani i parapsme i ketij vjeti asht tejkalue me 13,45 per qind, Ky rezultat na tregon se asht ba pune ne bet drejtim, Ne realizimin e planit ne perfshimjen e fuqive puntore, na kemi ba te mundeshem kryemjen e detyreve ne te gjitha sektoret e ndryeshem te ngritjes s'ekonomis s'one—detyre qe na paraqet plani i jone pesvjeçar, Persa i perket grumbullimit te fuqive punonjese ne Krahinen t'one, rezultatet mund t'ishin edhe ma te knaqeshme, por fakti asht qe rreth organizimit te punes per perfshimjen e fuqive punonjese jane ba disa gabime e leshime,

Qysh ne fillim ka qene paraqite si detyre kryesore para drejtorive te fuqive punonjese mbatja e rregullte e evidences mbi fuqin puntore. Kjo pune ne fillim nuk ka shkue ashtu si duhet, mbassi shumica e nenpunsave te drejtorive te fuqive puntore nuk e kane njofte si duhet detyren e tyne me qe si nepunes te rij u ka mungue eksperienca dhe n'anen tjeter nuk kane pase kualifikim shkolluer. Por me kohe edhe ne ket drejtim puna ka marre hov dhe ka pase suksese, gja qe kryesisht ka kontribue ma teper ne realizimin e planit persa i perket prodhimit te fuqive punonjese dhe pjesemarrjes se ketyne ne ndertimin e socjalizmit tene.

Nji faktor tjeter qe e ba pengue arritjen e rezultateve edhe ma te knaqeshme ka qene mos koordinimi i punes i drejtorive te fuqive punonjese me komisjonet e formueme prane keshillave te rrethit dhe te vendit, te cilat jane formue posaçrisht per me kontribue ne perfshimjen sa ma te madhe te fuqive puntore n'ekonomin t'one. N'anen tjeter, po ky bashkepunim ka munngue edhe ne mes te drejtorive dhe t'organizatave masovike, bashkepunim qe kishte per te kontribue shum ne perfshimjen sa ma te gjane te masave punonjese, te cilat do te plotesojshin nevojat neper sipermarrjet e ndryeshme ekonomike e ne tjera dege.

Punen e ka pengue ne ket drejtim edhe ndrrimi i shpeshte i nepunesave, keshtu qe ata te cilet jane emnue rishtas, ka kalue nji kohe deri sa jane njofte me punen e tyne.

Nga gabimet dhe leshimet qe jane ba ne kete vjet persa i perket perfshimjes se fuqive punonjese, drejtorit per fuqit puntore, sipermarrjet, organizatat masovike etj kane fitue eksperience per punen ne vjetin e ardheshem. Keshtu qe s'ka per te ngja ma qe puntoret te pranohen ne pune si dhe te leshohen nga puna pa dijen e seksjonit te punes.

Qendrimi ndaj puntoreve qe per heren e pare hyen ne pune ka per te qene ma i pershtatshem. Keta kane per t'u caktue neper pune te ndryeshme ku ma se miri e ma teper mund te kontribuojne. Dhe jo te ngjaje qe shperndamja e tyne te bahet pa plan, pse nji gja e ketille bie ne kundershtim me ndertimin e ekonomis s'one me plan. Vend-fjetja ushqimi, dhe vesh-mbathja ka per te qene ma e pershtatshme dhe do te kryhen me kohe.

Normat ne te gjitha sipermarrjet kane per t'u vue, keshtu qe çdo puntor do te shperblehet ne baze te punes qe ban.

Sipermarrjet dhe deget sindikale kane per t'u interesue ma teper per kualifikimin e puntoreve, per ngritjen e tyne ne fushen kulturale, ideo-politike, gja qe ka me ndihmue shum qe t'a baje puntorin koshjent te punes te tij, e ne ket menyre kontributi i tij te jete shum ma i madh se sa mund te jete te nji puntor ku mungon kjo ngritje.

Drejtorati i punes i Krahines s'one tue e pa se femna asht perfshi fare pak n'ekonomi, keshtu qe ka ngja nder pune te lehta, ku mund te sherbente femna jane caktue mashkujt qe fizikisht jane ne gjendje te mire dhe si te tille keta mund te kontribuojshin ne pune tjera ku kerkohet ma teper shtimja ne perdorin e fuqis se krahut. Prandaj, per me muejte me perfshi nji numer sa ma te madh femnash n'ekonomin t'one, drejtorati i punes i Krahines s'one, per çdo rreth e qytet ka formue komisjone te posaçme, te cilat do t'i kontrrollojne te gjitha vendet neper sipermarrje dhe nder dege tjera t'ekonomis s'one, ku jane caktue mashkujt e ne te cilat vende do te mundet me kontribue femna, Komisjoni mbassi t'arrije ne nji pasqyre te kjarte, ka per t'i marre te gjitha masat e rastit, qe te gjitha vendet, ku punojne mashkujt e puna asht e lehte, keta te zavendesohen me femna. Me kete rast pjesmarrja e femnave si ne sektorin e industris ashtu edhe nder te tjeret do te jete ma e madhe.

Disa raste per kujdesin e shendetit populluer ne Krahinen t'one

Nga se ne Krahinen t'one deri ne çlirimin e Vendit ka mbretnue mbrapambetunija kulturalo-arsimore dhe ekonomike, - viset t'ona kane qene ba çerdhja e tifos se morrit dhe te stomakut. Gjate luftes gjendja qe keqesue dhe ma teper. Prandaj me njihere mbas çlirimit te Vendit t'one u-perhap epidemija e tifos se morrit dhe semundje te tjera ngjitese. Vetem ne vjetin 1945 ka pase afer 10,000 te semunde nga tifoja e morrit. Gjithashtu ne vjetin 1946 ka pase afer 90.000 te semunde nga malarja.

Ne luften sistematike dhe me plan kundra tifos se morrit dhe semundjeve tjera ngjitese, pushteti populluer qysh ne vjetin 1946 ka arrijte suksese te mdha. Me interevenimin e shpejte dhe pluhnimin e gjane me pluhnin di-di-ti, ne vjetin 1947 jane çfaqe vetem 37 raste semundjeje nga tifoja.

Me sterpikjen me emulzjonin di-di-ti, me thamjen e moçaleve, pastrimin e kanaleve, jane zhduke mushkajat - bartesat e malarjes dhe insektet etj.- bartesat e dizenteris, tuberkulozit, te tifos se stomakut dhe semundjeve te tjera te zorreve. Keshtu, semundjet nga malarja ne vjetin 1947 jane pakesue 70 per qind ne krahasim me vjetin 1945.

Botimi i Keshillit Krahinuer te Frontit populluer—Sipermarrja per shtyp dhe botime "Milladin Popoviq„ Prishtine.
Pajtimet ne listegen i pranon Administrata dhe ekspedicioni. Numri i çekut 906038.